



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**  
**DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: [www.ildkpkj.al](http://www.ildkpkj.al), E-mail: [info@ildkpkj.al](mailto:info@ildkpkj.al)

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	
	<b>2021</b>

**DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE PERIODIKE VJETORE**  
**NË FORMAT ELEKTRONIK PËR SUBJEKTE NË FUNKSION**

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014, Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017 dhe Ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018.

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE**

Emri	Atësia	Mbiemri
<b>Jurgis</b>	<b>Shefqet</b>	<b>Çyrbja</b>
Funksioni		
<b>Deputet</b>		
Institucioni dhe adresa		
<b>Kuvendi</b>		
Data e emërimit në funksionin që kryen	Data e dorëzimit të deklaratës	
<b>09/09/2017</b>	<b>31/10/2022</b>	

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

**A u t o r i z o j:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.**

Nënshkrimi i subjektit deklarues

**Jurgis Çyrbja**

**DEKLARIMI I PASURIVE  
DHE  
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite sipas gërmës a, b, c, ç, d të nenit 4, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil, tuaja dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë, gjendje më dt. 31.12.2021, në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %
1.	<p>Aseti: Llogari bankare</p> <p>Detaje:</p> <p>Kategoria e llogarisë: Llogari page</p> <p>Lloji i llogarisë: Individuale</p> <p>Pjesa takuese: 100 %</p> <p>Balanca: -252,446.00 ALL</p> <p>Data e balancës: 31/12/2021</p> <p>Overdraft: Po</p> <p>Vlera e overdraft-it: 400,000.00 ALL</p> <p>Burimi i Krijimit:</p> <p>Tjetër</p>	-252,446.00 ALL	100 %

\* **Objekti i deklaramit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300,000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

**TË ARDHURA DHE ANGAZHIME  
NË VEPRIMTARI  
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër, për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021.

Përshkruani hollësisht të ardhurat, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë
Të ardhura nga paga Emërtimi: Kuvendi i Shqipërisë Nga data: 01/01/2021 Në datë: 31/12/2021 Shuma Neto: 2,713,552.00 ALL	2,713,552.00 ALL

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve, etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

**Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.**

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor 2021 (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor 2021 (Principal)
Overdraft  Data e fillimit: 09/08/2021 Shuma totale: 400,000.00 ALL Shuma e pashlyer: 252,446.00 ALL	123,207.00 ALL	252,446.00 ALL

### Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**Deklarimi i interesave private, periodike vjetore në formë elektronike, për subjekte në funksion, gjendje më dt. 31.12.2021**, duhet të plotësohet në sistemin elektronik online EACIDS nga zyrtari (subjekt deklarues) në funksion apo në detyrë më dt. 31.12.2021 dhe personat e lidhur me të.

- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit, gjendje më dt. 31.12.2021.

(Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave private dhe konfliktit të interesave për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave private periodike vjetore në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluar ndër vite dhe detyrimet financiare, që janë **gjendje në dt. 31.12.2021**, si dhe burimin e krijimit të tyre).

- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- **Deklarata e interesave private, periodike vjetore, në formë elektronike për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës 31 mars 2022, si vijon:**
  - **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI.
  - **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

**Deklarimi i interesave private, periodike vjetore, në formë elektronike, për subjekte në funksion, gjendje më dt. 31.12.2021**, duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, **për pasuritë që disponojnë veçmas**, dhe plotësojnë formularin përkatës, si vijon:

- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI.
- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse.
  - Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.

### Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200,000 (dyqind mijë) lekë deri në 500,000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal.
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

**Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.**

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, [info@ildkpk.al](mailto:info@ildkpk.al).

Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.

**Shënim:** Ky formular i deklarimit plotësohet vetëm një herë, për pasuritë e akumuluar ndër vite dhe dorëzohet në autoritetin përgjegjës të institucionit publik, brenda datës 31 mars 2022.